

MÖBELÖL



PËRSHKRIMI

Vaj lini natyral për mbrojtjen e sipërfaqeve të drurit duke i nxjerrë në pah ngjyrat brendshme dhe të jashtme

KARAKTERISTIKAT

- Kundër ujit
- Nxjerr në pah ngjyrën natyrale dhe cilësinë e drurit
- Depërton në dru duke mbushur poret pa formuar cipë

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Ideal për mirëmbajtjen dhe rifreskimin e drurit të fortë si dru tik, mahogan, iroko, si dhe të gjithë drunjtë e zhveshur.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	Përzierje e vajrave natyrale të modifikuara
Densiteti	0,95±0,05 gr/ml
Norma e përhapjes	Rreth 12m²/lit në dru të butë ose 15m²/lit në dru të fortë
Tharja	60±10 minuta
Tharja e plotë	3±½ orë
Koha e rilyerjes	16 orë
	Koha e tharjes dhe e rilyerjes mund të zgjatet në kushtet e temperaturës së ulët dhe lagështisë relative të lartë
Ngjyrat	Transparente

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Pastroni sipërfaqet nga boja e vjetër e dëmtuar, e pa ngjitur dhe pjesët e shkëputura duke bërë zmerilimin e sipërfaqes së drurit. Me anën e procesit të pastrimit me ajër eliminoni të gjithë pluhurat e krijuar nga procesi i zmerilimit si dhe elemente të tjera që pengojnë ngjitjen si graso, vajra, etj.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Fillimisht bëni hollimin e produktit duke përdorur diluentin e duhur deri në arritjen e viskozitetit të përshtatshëm për aplikim .

APLIKIMI

Aplikimi i produktit Möbelöl bëhet me anën e një sfungjeri, me furçë ose me rrul. Fillimisht derdheni produktin e përgatitur në enën mbajtëse. Më pas me anën e sfungjerit, furçës ose rrulit bëhet hapja e produktit mbi sipërfaqen e drurit. Aplikimi bëhet duke vendosur fillimisht shtresën e parë dhe më pas duke hequr tepricën në mënyrë që të bëhet mbushja sa më e mirë e sipërfaqes së drurit. Sigurohuni që druri të përthithë sasinë e duhur në mënyrë që të arrihet mbrojtja maksimale e tij. Pastroni mjetet e punës menjëherë pas përdorimit duke përdorur pastrues me bazë solventi.

PAKETIMI

Kanaçe 0.75lt

RUAJTJA

36 muaj, në qoftë se ruhet në paketim të mbyllur dhe në kushte normale.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e amballazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

SHËNIME

- Rekomandohet që të shmangët aplikimi i produktit në temperatura nën 5°C.

